

AKTI I THEMELIMIT

I

SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “ELA INVEST EXPORT IMPORT LOGISTIC COMPANY” SH.P.K.

Themeluesit qe nenshkruajne me poshte jane si vijon:

Z. Hakan Çelik, i datelindjes 17.10.1967, i biri i Safi-ut, lindur ne Elazig/Turqi, dhe banues ne Prilep/Maqedoni, mbajtes i pasaportes turke me nr. U 09756266 dhe me nr. Personal Turk 51175040216 madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Z. Abdullah Kildan, i datelindjes 01.03.1956, i biri i Mehmet-it, lindur ne Gundogmus/Turqi, dhe banues ne Prishtine/Kosove, mbajtes i pasaportes turke me nr. U 15078627 dhe me nr. Personal Turk 23968217716 madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar

Qe ne vijim do te quhen Ortaket e Shoqerise “ELA INVEST EXPORT IMPORT LOGISTIC COMPANY” SH.P.K.

Sot me date **23.08.2018**, bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosen te themelojne Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1

Objekti i shoqerise

Shoqeria Tregtare “ELA INVEST EXPORT IMPORT LOGISTIC COMPANY” SH.P.K, ka si objekt veprimtarie:

Kryerja e veprimtarive te ndryshme ne fushen e kerkimit, zbulimit dhe shfrytezimit te mineraleve ne siperfaqe, nentoke dhe karjera, prodhim dhe perpunim mineralesh si; shfrytezimit te mineraleve te kromit, nxjerrje e perpunim mermeri , ngritja e objekteve industriale te perpunimit dhe pasurimit te mineraleve, tregti me shumice dhe pakice, import-eksport mineralesh. Cdo aktivitet tjeter i konsideruar fitimprures dhe ne interes te

shoqerise ne menyre qe te permbushet qellimi i veprimtarise dhe qe nuk bie ne kundertshtim me legjislacionin Shqiptar.

Neni 2

Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise

Ortaket vendosen qe shoqerine t'a emertojne "ELA INVEST EXPORT IMPORT LOGISTIC COMPANY" SH.P.K.

1. Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne Autostrada Lezhe-Tirane nr.E762, Km 7,Godina nr.8, Manati, Lezhe.
2. Shoqeria mund te krijojte qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni 3

Forma Juridike

1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi
2. Me vendim te Ortakeve mund te ndryshoje formen juridike te Shoqerise, ne qofte se ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaket do te pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar, ne organet kompetente shqiptare.
3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
4. Shoqeria do te kete vulen e saj.



Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4

Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakeve

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.



3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne nje shoqeri tjeter ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaket marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vet ose nepermjet perfaqesuesve te tij.
6. Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

Neni 5

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar.

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR

Neni 6

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar eshte **100.000 (njqind mije) Leke**. Gjithseje **2 (dy) kuote**.

Ortaket e shoqerise jane:

Hakan Çelik zotëron 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 50.000 (pesedhete mije) Lek, qe perfaqeson **50% (pesedhete) te kuotave** të kapitalit themeltar të shoqërisë;


Abdullah Kildan zotëron 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 50.000 (pesedhete mije) Lek, qe perfaqeson **50% (pesedhete) te kuotave** të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Kreu IV

PERSONALITETI JURIDIK

Neni 7

Shoqeria fiton personalitetin juridik ne dite e rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar ne Qendren Kombetare te Biznesit, si dhe fillon veprimtarine e saj me marrjen e licences te ushtrimit se veprimtarise.



Kreu V
ADMINISTRIMI

Neni 8

1. Shoqeria do te administrohet nga administratori **Hakan Çelik**, i cili perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te tretet per nje periudhe 5 (pese) vjecare dhe me te drejte rizgjedhje.
2. Administratori mund t'i delegoje kompetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.


Kreu VI
DISPOZITA TE TJERA

Neni 9

1. Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakeve te saj, ta ndajne si dividend apo ta shtojne ne kapitalin e shoqerise.
2. Ky Akt shtypet dhe nenshkruset ne 4 (kater) kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore.
3. Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise.


ORTAKET

Hakan Çelik



Hakan Çelik

Abdullah Kildan



Abdullah Kildan

Perkonte:

ERGESS DERNISHI

